



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.541/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit A. S, sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.833/14 të dt.13.6.2016 për shkak të veprës penale: ndotja , degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit A. S dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.04.7.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.S i lindur me dt.16.8.1976 në fsh. Komuna e , ku edhe tani jeton, i biri i R dhe nënës H e gjinisë B, , Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me datë 03.4.2014 në kohë të pavërtetuar , në fsh. Gllaviqicë Komuna e Pejës , me dashje ka shkelur nenin të Ligjit për Miniera dhe Minerale si dhe nenin 49 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Minerat dhe Minalet , në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike është hasur nga inspektorët e KPMM së duke operuar ilegalisht dhe duke bërë përpunimin –seperimin e resurseve minerale dhe atë të rërës dhe zhavorrit , ku si pasojë e operimit ilegal ka bërë ndotjen apo degradimin e mjedisit duke shfrytëzuar pa masë burimet natyrore e për të cilën veprimtari nuk posedon leje për aktivitete të veçanta me çka te dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 5.000 euro .

-me çka ka kryer vepra penale : ndotja , degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 dhe nenit 347 par 1 të KPRK-së. **E**

GJYKON :

Me dënim me gjobë në lartësi prej 300 euro, e të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj brenda 3 muajsh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Nëse i pandehuri gjobën në fjalë nuk e paguan brenda këtij afati – dënimi me gjobë automatikisht do të shendohet në dënim me burg – duke llogaritur 20 euro = 1 ditë burg !.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro – 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.13.6.2016 kundër të pandehurit A. S ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.833/14 për vepër penale : ndotja , degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, fakti se i pandehuri është mbajtës i familjes 6 anëtarësh, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform neni 463 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.04.7.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .